



Rumeli

RUMELİ İSLÂM ARAŞTIRMALARI DERGİSİ

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية | Rumeli Journal of Islamic Studies

ISSN : 2564 - 7903 • Yıl / Year : İlkbahar / Spring 2018 • Sayı / Issue : 1



TRAKYA
ÜNİVERSİTELER BİRLİĞİ
İLAHİYAT FAKÜLTELERİ

RUMELİ

İslâm Araştırmaları Dergisi

مجلة روم ايدى للبحوث الإسلامية / Rumeli Journal of Islamic Studies

ISSN: 2564-7903

Yıl/Year: 1 -İlkbahar/Spring 2018 - Sayı /Issue: 1



RUMELİ İslâm Araştırmaları Dergisi

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية / Rumeli Journal of Islamic Studies
Yıl/Year: 1 - İlkbahar/Spring 2018 - Sayı /Issue: 1

Sahibi / Owner

Trakya Üniversiteler Birliği İlahiyat Fakülteleri Adına
Prof. Dr. Cevdet Kılıç, Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi

Editör / Editor

Dr. Mustafa Şentürk, Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi

Yardımcı Editörler / Co-Editors

Dr. Feim Gashi, Kırklareli Üniversitesi İlahiyat Fakültesi
Dr. Ümit Eker, Çanakkale OMÜ İlahiyat Fakültesi
Dr. Yakup Bıyıkoğlu, Tekirdağ NKÜ İlahiyat Fakültesi
Arş. Gör. Tuba Yıldız, Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi

Arnavutça Dil Editörü / Albanian Language Editor

Dr. İtir Rruqa, Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi

Yazı İşleri Müdürü

Dr. İtir Rruqa, Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi

Amblem Tasarım / Emblem Design

Dr. Ömer Kasım Kahya

Grafik Tasarım / Graphic Design

Alihaydar Murat KIŞTAN
Nokta Klâsik

Adres / Adress

Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi
Balkan Yerleşkesi 22030 Edirne- TÜRKİYE
Tel. 0 284 235 68 99
Fax 0 284 235 08 87
rumelislam@trakya.edu.tr

Basım Yeri/Printed By

Trakya Üniversitesi Matbaası
Edirne Teknik Bilimler MYO Sarayıcı Yerleşkesi EDİRNE



Basım Tarihi/Printing Date

Nisan - 2018



rumelislam@trakya.edu.tr



<https://www.facebook.com/rumeli.islamicstudies.3>



[@rumeliislam](https://twitter.com/rumeliislam)



www.ilahiyat.trakya.edu.tr, <http://dergipark.gov.tr/rumeli>

Uluslararası Danışma Kurulu/Int. Advisory Board

Dr. A. Taha İmamoğlu, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Abdurrahman Okuyan, Ondokuz Mayıs Üni., Türkiye
 Dr. Adem Apak, Uludağ Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmad Omar, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmad Sawan, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmet Çapku, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmet Emre Dağtaoğlu, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmet Faruk Güney, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmet Öz, Kahramanmaraş S.İ. Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ali Karataş, Sakarya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ali Öztürk, İstanbul Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Bayram Ali Çetinkaya, İstanbul Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Bekir Zakir Çoban, Dokuz Eylül Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Fahrush Rexhepi, University of Pristina, Kosova
 Dr. Faredin Ebibi, University of Skopje, Makedonya
 Dr. Fatih Toktaş, Dokuz Eylül Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Fatih Yakar, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Habibe Kazancıoğlu, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Halil Aldemir, Kilis Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Halim Işık, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Hasan Coşgun, Gaziosmanpaşa Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Hasan Maçın, Adıyaman Üniversitesi, Türkiye
 Dr. İbrahim Kocabaş, Yıldız Teknik Üniversitesi, Türkiye
 Dr. İlyas Çelebi, İstanbul 29 Mayıs Üniversitesi, Türkiye
 Dr. İrfan Morina, University of Pristina, Kosova
 Dr. İsmail Çalışkan, Yıldırım Beyazıt Üni., Türkiye
 Dr. Mahmut Yazıcı, Namık Kemal Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mehmet Dalkılıç, İstanbul Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mehmet Demirtaş, Gaziosmanpaşa Üni., Türkiye
 Dr. Mehmet Kenan Şahin, Ordu Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mehmet Ümit, Marmara Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Muammer Bayraktutar, Gaziosmanpaşa Üni., Türkiye
 Dr. Murat Sula, Karadeniz Teknik Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mustafa Hocaoğlu, RTE Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mustafa Necip Yılmaz, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Mustafa Özel, Şehir Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Muzaffer Özli, Fırat Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Nazar Omran, Int. University of Novi Pazar, Sırbistan
 Dr. Nebile Özmen, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Necdet Şengün, Dokuz Eylül Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Necdet Ünal, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Necmettin Gökkır, İstanbul Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Nevzat Aydın, Bayburt Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Nurullah Altaş, Marmara Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Oğuzhan Ş. Yağmur, Dokuz Eylül Üni., Türkiye
 Dr. Ömer Başkan, Abant İzzet Baysal Üni., Türkiye
 Dr. Ömer Soner Huncan, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Özkan Öztürk, Namık Kemal Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ramadan Doğan, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Raşit Küçük, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Rıdvan Canım, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Sema Geyin, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Serpil Başar, Diyanet İşleri Başkanlığı, Türkiye
 Dr. Seyfullah Efe, Dokuz Eylül Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Siham Mevid, Int. University of Novi Pazar, Sırbistan
 Dr. Suat Erdem, Bozok Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Süheyl Ünal, Dokuz Eylül Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Thaer Alhallak, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Yakup Yılmaz, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye

Dr. Yasemin Sarı, Namık Kemal Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Yusuf Şen, Bayburt Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Zübeyir Bulut, Abant İzzet Baysal Üni., Türkiye

Uluslararası Yayın Kurulu/Int. Editorial Board

Dr. Safvet Halilović, University of Zenica, Bosna Hersek
 Dr. Almir Fatić, University of Sarajevo, Bosna Hersek
 Dr. Zuhdija Hasanović, Uni. of Sarajevo, Bosna Hersek
 Dr. Sulejman Topoljak, University of Bihac, Bosna
 Dr. Şukriya Ramiç, University of Zenica, Bosna Hersek
 Dr. Abas Jahja, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ahmad Sawan, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Ali Hüseyinoğlu, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Behlül Kanaçi, Karadağ İslam Birliği, Karadağ
 Dr. Cevdet Kılıç, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Emina Sadikovic, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Emine Arslan, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Enver Gicic, Int. University of Novi Pazar, Sırbistan
 Dr. Fatih Köse, Namık Kemal Üniversitesi, Türkiye
 Dr. İrfan Morina, University of Pristina, Kosova
 Dr. Mensur Nuredin, University of Skopje, Makedonya
 Dr. Mesut İdriz, Int. University of Sarajevo, Bosna Hersek
 Dr. Mohammad Jaber Thalji, Yarmouk University, Ürdün
 Dr. Muhammed Altaytaş, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Muzaffer Üzümcü, Namık Kemal Üni., Türkiye
 Dr. Nevzat Erkan, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Nimetullah Akın, Çanakkale Onsekiz Mart Üni. Türkiye
 Dr. Nizamettin Karataş, Namık Kemal Üni., Türkiye
 Dr. Nurullah Koltas, Trakya Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Salih İnci, Kırklareli Üniversitesi, Türkiye
 Dr. Sefer Hasanov, Sofya Yüksek İslam Ens., Bulgaristan
 Dr. Selahattin Aktı, Çanakkale Onsekiz Mart Üni., Türkiye
 Dr. Üzeyir Durmuş, Çanakkale Onsekiz Mart Üni., Türkiye
 Dr. Mead Osmani, Araştırmacı, Sırbistan

İÇİNDEKİLER

İÇİNDEKİLER 5

ZİBER LATA

HAFİZ VILDAN FAİK DİBRA: ATDHETAR, DIJETAR DHE HOXHË I SULLTANIT 8

ABDULXHEMİL NESİMİ

RËNDËSIA E HIFZIT (MEMORİZİMIT) TË KUR'ANIT FAMËLARTË DHE PËRKUSHTIMI I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË NË MBROJTJEN E TIJ 17

HUSEİN RIZAI

BALKANLAR'DA İSLÂMÎ DÜŞÜNÇENİN GELİŞİM SÜRECİ 32

MERAL JAHJAI

MAKEDONYALI KEMAL ARUÇI'NİN HÜSEYİN COZO'YA YAZDIĞI REDDİYE 52

İSMAİL KILIÇ

KUR'AN'DA OLUMSUZ BİR VASIF: MÜDÂHENE 105

MUSTAFA AKMAN

CELÂLEDDİN ED-DEVVÂNÎ'NİN ESERLERİ VE ÖZET OLARAK TANITIMI 122

ABDULLAH TAHA İMAMOĞLU

BİR İLİM ADAMI VE GÖNÜL EHLİ OLARAK ZÜLFİKAR TÜCCAR 161

MAHMUT KAYA

ZÜLFİKAR TÜCCAR'IN ARDINDAN (1949-2014) 173

Në mesin e këtyre patriotëve dhe hoxhallarëve janë edhe një sërë hoxhallarësh dibranë, si Haxhi Vehbi Dibra, Sait Najdeni (Hoxhë Voka i Dibrës), Hoxhë Muglica, Haxhi Hafiz Vildan Faik Dibra etj. Ata ishin diplomatë të denjë, sepse lanë gjurmë në historinë e Perandorisë Osmane dhe në të njëjtën kohë, ishin personalitete të dalluara edhe në skenën e historisë shqiptare. Pavarësisht se shumë prej patriotëve hoxhallarë që u përmendën me lartë janë edukuar në Stamboll apo vende të tjera të perandorisë, përsëri ata gjithmonë kanë qenë të lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët duke kontribuar në mënyra të ndryshme.¹

I tillë ishte Faik Dibra, bashkëpunëtori më i ngushtë i vëllezërve frashëri, lobuesi i shkollave shqipe, pjesëmarrësi në Kongresin e Manastirit, mbrojtësi i vlerave të Kongresit të Dibrës, pajtuesi i shqiptarëve të ndarë në Elbasan, autori i shumë veprave fetare dhe filozofike, veterani i arsimit dhe hoxha i sulltanit.

1. Biografia e Veprimeve të Haxhi Vildanit

Haxhi Vildan Faik Dibra lindi në vitin 1852 në Sanxhakun e Dibrës, gjegjësisht në kazanë e Rekës të fshatit Presojnicë.² Babai i tij Abdusselami, ishte një bujk fisnik dhe një Aga i njohur i myslimanëve të atyre anëve. Nëna e tij quhej Zulfije, një zonjë dhe një edukatore e mirëfilltë.³

Kur ishte tetë vjeç, bashkë me familjen u shpërngulën në Turqi dhe u vendosën në lagjen Üsküdar (Yskydar) të Stambollit.⁴ Kjo e dhënë e cila qarkullon nëpër literaturën turko-osmane, tregon se Faik Dibra ka shkuar në Stamboll në një moshë relativisht të re, jo siç supozojnë disa studiues se ai ka mbaruar shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje dhe pastaj ka migruar në Turqi. Përveç fakteve bibliografike dhe arkivore të përmendura, se Faik Dibra është shpërngulur shumë herët, e tregon edhe pamundësia për t'u shprehur lirshëm në gjuhën shqipe para anëtarëve të shoqërisë “Bashkimi” kur u nis për në Kongresin e Manastirit. Orientalisti Hasan Kaleshi rreth kësaj çështjeje ka nënvizuar:

¹ Shih: Ilir Rruga, *Arnavutluk'ta İslâm – Hristiyanlık Karşılaşması (1385-1600)* (Doktora Tezi, Çanakkale Onsekiz Mart Üniversitesi - Sosyal Bilimler Enstitüsü, 2016), f. 144-145, 157; Semavi Eyice, “İmrahor İlyas Bey Camii”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, (Ankara: TDV Yayınları, 2000), 22: f. 228.

² Hasan Ekmen, *Üsküdarlı Meşhurlar Ansiklopedisi*, Üsküdar Belediye Başkanlığı Kültür ve Sosyal İşler Müdürlüğü, İstanbul 2012, f. 384. Gjithashtu shih: Sula, Murat. “Debreli Vildân Fâik ve Teshîlu'n-Nahv'î”. *Dokuz Eylül Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 29/2009: 29, f. 125.

³ Arzu Güldöşüren “Vildan Faik Efendi”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, 43, İstanbul 1988, f. 108.

⁴ H. Ekmen, *Üsküdarlı Meşhurlar...* f. 384

“Në lidhje me fjalimin e hoxha Vildan Efendiut që bëri fjalë për lirinë, vetëdijen dhe bashkimin. Folësi duhet nisur – tha- se me qenë se ka ikur i vogël nga mëmëdheu dhe s’e përdor dot bukur gjuhën shqipe, kërkoj leje të flas turqisht; fjalët ca nga ca përktheheshin në shqip prej Abdul Bej Ypit.”⁵

Siç nënkuptohet të gjitha këto tregojnë se Faik Dibra ka shkuar shumë herët në Stamboll, por gjithsesi nuk përjashtohet edhe mundësia e të mësuarit ndonjë vit në mektebet e vendlindjes përpara emigrimit, megjithatë për to nuk kemi informacione dhe dokumente që ta vërtetojnë një gjë të tillë.

Njohuritë e para i mori në mektebin “Fıstıklı” nga kryeimami i xhamisë “Selimije” në Üsküdar, nga Hoxha Hafız Sabri Efendiu. Në moshën dymbëdhjetë vjeçare u bë hafız i Kur’anit Famëllartë, kurse në moshën katërbëdhjetë vjeçare u kualifikua (mori ixhazet) për shtatë dhe dhjetë kiraetet.⁶ Përsëri studimet e mëtejshme i vazhdoi në Stamboll, si shumë shqiptarë të tjerë edhe ky pati rezultate të shkëlqyera në përfundimin e medresesë së lartë “Kara Mustafa Efenedi”, kështu që në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare u diplomoi me sukses. Në vitin 1882 u emërtua ligjërues në xhaminë “Yeni Valide Camii” në Üsküdar dhe në mektebin pranë xhamisë, detyrë të cilën e ushtroi deri në vitin 1912.⁷ Në vitin 1885 ai mori epitetin “Mësuesi i Yskydarit”.⁸ Po ashtu, i vlerësuar për përgatitjen e lartë që kishte fituar, u emërua profesor në medresenë e lartë të Üsküdarit. Në këtë pjesë të Stambollit, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit XIX dhe sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të kaluar XX, kishte po ashtu shumë shqiptarë të tjerë në Stamboll.

Ai ka qenë shumë aktiv edhe në veprimtari të tjera shkencore dhe në ligjërime para sulltanit, të quajtura “Huzur dersleri”. Me 5 korrik të vitit 1925 në lagjen “Hacı Hesna Hatun” të Üsküdar, ai ndërroi jetë dhe u nda nga kjo botë. Me porosi paraprake ai u varros në varrezat “Karacaahmet Mezarları” në një qosh pranë të bijës Emine Tajibe.⁹

⁵ Hasan Kaleshi, “Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll”, *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë: 1969, f. 114.

⁶ Kualifikim për format e ndryshme të leximit të Kuranit. Kjo është aftësi të cilën e zotërojnë vetëm dijetarët e mirëfilltë të botës islame, bile pak kush e mbërrin në moshën kaq të re sa Vildan Faik Dibra.
H. Ekmen, *Üsküdarlı Meşhurlar...* f. 384

⁷ A. Güldöşüren “Vildan Faik Efendi”, *Türkiye Diyanet...* f. 108.

⁸ H. Ekmen, *Üsküdarlı Meşhurlar...* f. 385. Gjithashtu Shih: Arzu Güldöşüren, “Arnavutluk’tan İstanbul’a Bir Âlim Portresi: Debrelî Vildan Faik Efendi”, *Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 48/ 2015, f. 118-123.

⁹ H. Ekmen, *Üsküdarlı Meşhurlar...* f. 385.

Dibra bashkë me Rekën janë territor ku kanë lindur dhe janë edukuar shumë personalitete të lëvizjes kombëtare. Siç mund të mendohet ata nuk janë vetëm trima e luftëtarë me armë, por edhe luftëtarë me penë, siç ishte edhe Vildan Faik Dibra nga Presojnica e Rekës.

Faik Dibra i takon plejadës së hoxhallarëve të shquar të cilët dhanë kontribut të dukshëm në shumë sfera të jetës, si në aspektin shkencor fetar dhe atë patriotik, siç mund të përmenden Haxhi Vehbi Dibra, Sait Najdeni, Hafiz Maliq Tanusha, nga Tanusha e Rekës, idhtar i zjarrtë i Klubit të Stambollit, Hafiz Abdurrahim Dauti propagandues dhe mësues i gjuhës shqipe etj.

2. Kontributi i Faik Dibrës për kombin dhe gjuhën shqipe

Vildan Dibra, duke qenë një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Vëllezërve Frashri, i cili u aktivizua në lëvizjen kombëtare të fillimit të shek. XX., mori pjesë në Klubin "Bashkimi" të Stambollit të cilin ai e përfaqësoi atë në Kongresin e Manastirit të 1908-ës. Përveç këtij kontributi, mund të përmenden edhe këto kontributet tjera të Faik Dibrës:

2.1. Përpjekja Në Votimin e Kandidatëve Shqiptarë

Më 23 Korrik 1908 u dha dekreti që të mbahen zgjedhje dhe të legjitimohej parlamenti osman, prandaj gjatë fushatës parazgjedhore për t'u shtuar numri i deputetëve shqiptarë, një rol të rëndësishëm luajti delegacioni i Klubit të Stambollit në krye me Faik Dibrën, i cili vizitoi disa vise të vilajetit të Manastirit dhe të Shkodrës, ku propagandoi që kudo të votoheshin kandidatët shqiptarë. Me influencën e tij Faik Dibra ia doli që në Elbasan të bënte pajtimin publik midis dy grupimeve politike të shqiptarëve të këtij qyteti, që ishin armiqësuar shumë mes njëri tjetrit.¹⁰ Nga këtu shihet se Hoxha në fjalë ka kontribuar në shumë sfera të jetës.

2.2. Në Kongresin e Manastirit

¹⁰ AIH, Vj-18-2-242, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkodra, dt. 28 dhjetor 1908, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë; Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, libri I, Prishtinë: 2004, f. 146.

Qëndrimi i klubit të Stambollit, i cili në fillim e përkrah alfabetin latin e më vonë nën presionin e qeverisë, sidomos të një pjese të madhe shqiptarësh që zënë pozita jashtëzakonisht të larta fetare e hekën përkrahjen. Pikërisht në lidhje me këtë pikë, kisha vënë në pah se ndër disa shkrime gjejmë se klubi i Stambollit qysh në fillim ka pasur qëndrim negativ ndaj alfabetit shqip. Në saje të numrit të parë të "Besës" së Stambollit, dihet se “të hënën mbrëma, u nisën me tren për në Arnautllëk Ismail Hakki, Faik Dibra, Shaqir Efendiu, Fazil Pashë Toptani, deputet i Prishtinës Fuat Pashë Prishtina, Riza beg Dibra, Maliq beg Luma, të gjithë anëtarë të shoqnisë shqiptare “Bashkimi”.¹¹ Në stacion u përcollën nga një shumicë e anëtarëve të klubit. Me këtë rast para nisjes së trenit, haxhi Vildani e mbajti një fjalim të bukur i cili u prit me një duartrokitje të madhe. Në kongres ekzistonte një farë frike nga qëndrimi i delegatëve të klubit të Stambollit, sepse në klubin e Manastirit mbretëronte një bindje e thellë se ata janë në realitet delegatë të xhonturqve dhe se do ta kërkojnë përvetësimin e alfabetit arab. Mirëpo këtë mendim e kundërshtoi Faik Dibra. Pasi e demaskoi sundimin despotik të Abdulhamitit dhe e lëvdoi kushtetutën ai e theksoi:

“Nevojën e bashkimit të shqiptarëve, të cilët tani do të bashkohen edhe me një alfabet, e alfabeti – tha Faik Dibra – është një vegël e fuqishme që i përshtatet më së miri gjuhës së tij, prandaj shqiptarët e zgjedhin alfabetin shqiptar. Turqit e asaj kohe gjithashtu nuk kishin shkronja për ta shkruar gjuhën e tyre – ata i kanë adaptuar shkronjat arabe. Sa për drejtimin se si lypsej të shkruhej – nga e majta në të djathtë, apo nga e djathta në të majtë – kjo nuk është punë me rëndësi. Sa i përket fesë, ajo i takon zemrës së njeriut, kështu që secili është i lirë t’i ketë pikëpamjet e veta.”¹²

Gjergj Qiriazi pohon se fjalët e Faik Dibrës patën ndikim të fuqishëm në “mendjen e shumë myslimanëve që mendonin se ata nuk duhej të shkruanin si të krishterët”. Këtë e provon edhe konsulli Austro-Hungarez i Shkodrës.¹³

Qëndrimi i tij pro ose kundër alfabetit të Stambollit në këtë kongres, kishte një peshë të madhe. Shumë nga pjesëmarrësit prisnin se nga do të anonte Faik Dibra, duke shprehur pikëpamjen e tij në bazë të thënieve Kur’an’ore, theksoi: “Feja dhe Kur’an’i nuk kanë kurrfarë lidhje me alfabetin”.¹⁴

¹¹ Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton University Press: 1967, f. 373.

¹² H. Kaleshi, “Disa aspekte të luftës...”, f. 106.

¹³ Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare...* f. 124

¹⁴ Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 125

2.3. Përpjekja për ta Ndaluar Ndëshkimin e Xhavit Pashës për Konkluzionet e Kongresit të Dibrës

Përveç kontributit në Kongresin e Manastirit, anëtarët e klubit “Bashkimi” të Stambollit, ndër ta edhe Haxhi Vildani, bënë përpjekje për ta parandaluar ekspeditën e Xhavit Pashës kundër konkluzioneve të Kongresit të Dibrës. Ata formuan një delegacion, të përbërë prej: Ibrahim Temo, Faik Dibra dhe Sami Kulla, i cili me anë të një shkrese kërkoi prej Ministrit të Punëve të Jashtme Talat Beut që të hekë dorë nga ekspedita ndëshkimore e Xhavit Pashës. Ata i propozuan ministrit të bëjnë një marrëveshje dhe të formojnë një komision që t’i nxjerr në shesh se përse ndodhin të gjitha këto trazira,¹⁵ pavarësisht se kërkesa e tij nuk u mor parasysh.

2.4. Përhapja e Shkollave Shqipe në Trevat Shqiptare

Faik Dibra u zgjodh kryetar i komisionit për përhapjen e shkollave shqipe në vilajetin e Manastirit dhe të Shkodrës.¹⁶ Përzgjedhja e Faik Dibrës për këtë detyrë të rëndësishme nuk ishte e vështir për atë, sepse ai ishte një personalitet i njohur dhe një veteran i arsimit në Perandorinë Osmane, kështu që kishte njohuri të hollësishme për plan-programet dhe formën e realizimit të tyre. Për arsye se ai ishte njohës i mirë i sistemit arsimor.

2.5. Erudicioni i Haxhi Vildanit dhe Kontributi në Disiplinat Fetare

Faik Dibra krahas kontributit kombëtar, ai ka qenë një dijetar i mirëfilltë i disiplinave fetare. Ai është autor i disa veprave letrare-fetare e filozofike të shkruara në gjuhët persisht, arabisht dhe Osmanisht (turqishtes së vjetër). Gjithashtu ai është autor edhe i monografive në lëmin e drejtësisë, në kuadrin e të drejtës së shariatit.

Faik Dibra me cilësinë e përfaqësuesit të Komitetit të Stambollit mbajti një varg ligjëratah gjatë vitit 1908 në disa qytete të Shqipërisë. Këto ligjërata dëshmojnë për erudicionin e tij, ndjenjën patriotike dhe elokuencën profesionale.

¹⁵ Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 233

¹⁶ Ruzhdi Lata, “Kontributi i ulemave dibranë për çështjen shqiptare”, në konferencën: “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, Tiranë, 28-29 shtator 2012, f. 47

2.5.1. Veprat e Haxhi Vildan Faik Dibrës

Veprat e shkruara në disa gjuhë orientale dhe të botuara edhe në gjuhën Turke janë të ndryshme. Në vazhdim do t'i numërojmë disa vepra të këtij eruditi shqiptar, i cili la gjurmë anembanë botës:

- “Terşihul Kalem fi Lamiyatil Acem” (1308 h);
- “Esrarus Saum” (Stamboll, 1315 h);
- “El-Kavlu thabit fi kazail fevaid” (Stamboll, 1307 hixhri);
- “Teshilul Sarf” (Stamboll, 2009 m);
- “El-mevaizul hisan fima kurrire bejne jedeji sulltan” (Stamboll, 1330);
- “Medrese Hatırları”.

Këto dhe shumë vepra të Haxhi Vildan Faik Dibrës janë vepra të botuara, por ka edhe shumë vepra dhe shkrime të tjera të cilat kanë dalë nga dora e artë e këtij dibrani.

3. Hoxhë i Sulltanit

Në Perandorinë Osmane, në periudhën prej vitit 1738-1924 mbaheshin ligjërata profesionale fetare në prani dhe në pallat të Sulltanit të ashtuquajtura “huzur dersleri”. Ato mbaheshin në fillim të muajit të Ramazanit dhe zgjasnin tetë ditë. Ç’do seancë kishte një mukarrir (ligjërues) dhe disa muhatapë (diskutantë) përreth. Në mesin e këtyre hoxhallarëve që i dhanë mësim Sulltanit merrte pjesë edhe Faik Dibra, i cili prej vitit 1906 mori postin diskutant. Prej vitit 1909 deri në vitin 1922 u bë ligjërues (mukarrir) në oborrin e Sulltanit, gjegjësisht në “huzur dersleri”.¹⁷ Në ligjërimet para sulltanit ka ligjëruar tema të ndryshme, por më të njohurat kanë qenë ato në lidhje me komentimin e Kur’anit.

Konkluzion

Vërehet se punimet shkencore të deritanishme rreth Faik Dibrës, i kanë kushtuar më shumë vëmendje aktivitetëve kombëtare të këtij personaliteti, ndërkohë nga ana tjetër kanë lënë në harresë kontributin e tij të madh fetar. Gjithsesi mund të thuhet se aktiviteti i tij profesional në sferën e fesë është shumë herë më i bujshëm dhe më meritues për t’u trajtuar

¹⁷ Enver Demirpolat, “Huzur Derslerine Katılan Harputlu Alimler”, *Fırat Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, XVII/2 (2012), f. 235.

pasi vërehet shumë qartë kontributi i tij në këtë drejtim. Sepse Haxhi Hafiz Vildan Faik Dibra ka qenë vërtetë një profesionist i dalluar në fushën e interpretimit (tefsirit) të Kur'anit Fisnik.

Bibliografia:

- Abdyli, Ramiz. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, libri I, Prishtinë: 2004.
- AIH, Vj-18-2-242, *Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkodra*, dt. 28 dhjetor 1908, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.
- Demirpolat, Enver, “Huzur derslerine katılan harputlu alimler”, *Fırat Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, XVII/2 (2012), f. 235.
- Ekmen, Hasan (Genel yönetmen). *Üsküdarlı Meşhurlar Ansiklopedisi*, Uskudar Belediye Başkanlığı Kültür ve Sosyal İşler Mudurluğu, İstanbul, Ocak: 2012.
- Eyice. Semavi. “İmrahor İlyas Bey Camii”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, 22: 228-231. (Ankara: TDV Yayınları, 2000).
- Güldöşüren, Arzu. “Arnavutluk’tan İstanbul’a Bir Âlim Portresi: Debreli Vildan Faik Efendi”, *Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 48/ 2015, f. 117-148.
- Güldöşüren, Arzu. “Vildan Faik Efendi”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, 43: 108, (İstanbul: TDV Yayınları, 1988).
- Kaleshi, Hasan. “Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll”, në “Gjurmime Albanologjike”, nr. 1, Prishtinë: 1969;
- Lata, Ruzhdi. “Kontributi i ulemave dibranë për çështjen shqiptare”, *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, (Tiranë: 28-29 Shtator 2012) Komuniteti Mysliman Shqiptar,
- Rruga. Ilir. *Arnavutluk’ta İslâm – Hıristiyanlık Karşılaşması (1385-1600)*, Doktora Tezi, Çanakkale Onsekiz Mart Üniversitesi - Sosyal Bilimler Enstitüsü, 2016.
- Skendi, Stavro. *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton University Press: 1967.
- Sula, Murat. “Debreli Vildân Fâik ve Teshîlu’n-Nahv’i”. *Dokuz Eylül Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 29/2009: 29, f. 123-17.

RËNDËSIA E HIFZIT (MEMORIZIMIT) TË KUR'ANIT FAMËLARTË DHE PËRKUSHTIMI I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË NË MBROJTJEN E TIJ

Abdulxhemil Nesimi*

Abstrakt

Kur'ani i Shenjtë është zëri i së vërtetës, është fjalë e Zotit e cila me bukurinë e të shprehurit dhe me përmbajtjen kuptimplotë i tejkalon aftësitë njerëzore, i cili është shpallur Muhamedit (a.s), në përmbajtje të mus'hafit e përcjellur me traditë gojore në mënyrën më suksesive, leximi i të cilit është adhurim.

Paraqitja e Kur'anit te arabët i befasoj ata, sepse, asnjëherë më parë nuk kishin dëgjuar fjalë dhe shprehje më të qarta dhe më të bukura se ai. Duke e njohur mirë Muhamedin (a.s) ata vet dëshmuar se fjalët e Kur'anit nuk ishin fjalët e tij. Stili i lartë artistik, retorika, përputhshmëria, bukuria e shqiptimit, fjalët e qarta dhe radhitja e përsosur e tyre, bëri që Kur'ani t'i sfidojë një herë e përgjithmonë arabët dhe ti mahnis ata pa masë. Madje, edhe pse kanë kaluar XV shekuj nga zbritja e tij, ai ka qëndruar i pandryshuar në formën e tij të shkruar dhe gjuha e përdorur në të është po në të njejtën shkallë me gjuhën e sotme.

Duke patur në konsideratë popullin arab i cili dallohej nga popujt tjerë në të mësuarit e shpejtë përmendësh, i Dërguari i Zotit me që ishte analfabet, tentonte që çdo send ta mësoi përmendësh nga ajo çka i shpallej, derisa i premtoi All-llahu Fuqiptotë se do t'ia tuboj atë në zemër e tij, dhe do t'i mundësohet lehtësimi i leximit të fjalëve të Kur'anit dhe kuptimit të Tij: *“I lartë është All-llahu, Sundues i vërtetë. Ti mos nxito me Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij te ti, dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!”* (Taha:114).

Nisur nga kjo, edhe shqiptarët, sikur Muslimanët tjerë të botës, brez pas brezi kanë kultivuar traditën e të mësuarit të Kur'anit përmendësh, nga gjiri i së cilit do të dalin hafiz të shquar. Andaj, në kuadër të hulumtimi do të përpiqem sadopak t'i hedh një vështrim memorizimit të Kur'anit Famëlartë te

*Doc. Dr. Abdulxhemil Nesimi, Fakulteti Shkencave Islame Shkup, abdulxhemil_nesimi@hotmail.com.

Muslimanët e Maqedonisë, duke u kufizuar në një territor të caktuar siç është pollogu me rrethin, i bindur në atë se ky institucion ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë fetar dhe kombëtar.

“Kur’ani është një libër, i cili, sa herë që e marrim ta lexojmë, vazhdimisht na ngjall neveri, por më pas na tërheq, na habit dhe së fundi na imponon respekt.”

(Johann Wolfgang von Goethe)

Fjalët Kyçe: Kur’an, Mrekulli, Memorizim i Kur’anit, Hifz, Shqiptarë, Historia e Hifzit, Maqedoni.

KURAN-I KERİM’İN HIFZ EDİLMESİNİN ÖNEMİ VE MAKEDONYA’DAKİ ARNAVUTLARIN HIFZA VERDİKLERİ ÖNEM

Öz

Kuran-ı Kerim gerçeğin sesidir. O, Allah kelimidir. Peygamber efendimiz Muhammed (s.a.v.)’a tevatür yoluyla indirilmiştir. Mushaf olarak da nesilden nesile ezberlenerek aktarılmış, okunması ibadet olan bir kitaptır.

Arap yarımadasında Kuran-ı Kerimin indirilmesi en çok müşrik ve kafirleri şaşırtmıştır. Çünkü, daha önce bu gibi açık ve güzel sözleri duymamışlardı. Peygamber efendimizi iyi tanıdıklarından dolayı da bu sözlerin onun sözleri olmadığına kanaat getirmişlerdir. Yüksek bir sanat stiliyle, konuşma diliyle, uyumluluğuyla, ifade güzelliğiyle, muhteşem sözlerinin dizilişiyle Kuran-ı Kerim Arap topluluğunu etkilemiş büyüleyici bir ilahi kitaptır. Bununla birlikte nazil olması XV asır geçmesine rağmen günümüze kadar nazil olduğu dil ve şeklinde kalmış, kıyamete kadar da kalacağı garanti edilmiş olan Allahın sözleridir.

Arap toplumu, hızlı ezberleme konusunda diğer milletlerden farklılık gösteren bir millettir. Peygamber efendimiz eğitim almamış biri olmasına rağmen vahyedilen Allahın kelamını büyük bir heyecanla ezberlemiş, bu heyecan Allah c.ş. Kuran-ı Kerim’i kalbine yerleştireceğini ve okuma ve anlama kolaylığı sağlanacağını ayetle bildirene kadar devam etmiştir. Taha 114. Ayette Allah

c.ş.'u: *Gerçek hukumdar olan Allah yucedir. Sana vahyedilmesi tamamlanmadan once Kur'an'ı okumakta acele etme. "Rabim! Ilmimi arttir"* diye buyurmuştur.

Arnavut topluluğu da bu geleneği devam ettirerek Kuran-ı Kerimi ezberleyerek nesilden nesile aktarmaya devam etmiştir. Makedonyanın polog bölgesinde yaşayan müslümanlar üzerinde yapmış olduğumuz bu çalışma da göstermektedir ki, Kuran-ı Kerimin'in ezberlenmesi ve nesillere aktarılması, hem dini hem de milli tarihimize büyük katkıları olduğu tespit edilmiştir.

Anahtar Kelimeler: Kur'an, Mucize, Hifz Etmek, Kur'an Hafızı, Arnavut, Hifzetmenin Tarihi.

Hyrje

Termi Hifz i referohet procesit të mësimet përmendësh të tekstit Kur'anor në tërësinë e tij ose ndonjë pjesë të tij. Në aspektin gjuhësorë termi "*Hafiz*" vjen nga folja arabe (*hafedhe - jahfedhu*) që ka kuptimin: me mbrojt-ruajt, mba në mendje, memorizim etj. që ka ardh nga folja (ha-fi-dha)¹. Ndërsa ai i cili memorizon Kur'anin në tërësi quhet (Hafizul-Kur'an el-Karim – Kujdestar/Ruajtës i Kur'anit të Shenjtë).

Hifzi ka filluar bashkë me shpalljen e Kur'anit Famëlartë. Ç'do ajet që i shpallej Muhammedit (a.s) e memorizonte në shpirtin dhe zemrën e tij. Prandaj Muhammedi (a.s) është hafizi i parë i Kur'anit, ndërsa Xhebraili ishte muhaffiz i tij (mentor). Më pas vijnë katër halifet e drejtë/hulefa-i Rashidîn: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu (r.a); nga muhaxhirët: Talha bin Ubejdullahu, Sa'd bin Ebi Vakkasi, Ebu Hurejre; ndërsa nga sahabet femra: Aisheja, Hafseja, Ummu Seleme; nga ensarët Ubejd bin K'abi, Muadh bin Xhebeli, Zejd bin Thabiti, Zejd el-Ensari, Ebu Derda r.a, etj. Si do që të jetë, numri i hafizëve në kohën e Pejgamberit (a.s) ishte i shumtë, derisa në luftën e Jemames numri i hafizëve të vranë arriti mbi 140. Në lidhje me këtë el Kurtubi ka thënë: "Në Jeumul Jemame u vranë 70 kur'aë, ndërsa në kohën e Pejgamberit (a.s) në Biër Meune u vranë po kaq hafidha."

Veçohen dy qendra kryesore të memorizimit të Kur'anit, njëra në Mekë, e cila quhej "Darul-Erkam", ndërsa tjetra në Medinë ishte vendi pranë Xhamisë së Pejgamberit (a.s), e

¹ Teufik Muftić, *Fjalor arabisht-boshnjakisht* (Sarajevë, 2004, rrënja: ح ف ض), f. 311.

quajtur “As’habus-Suffa”. Ne këto dy qendra, shumë nga sahabët e kanë mësuar Kur’anin përmendsh.

Në periudhat e mëvonshme mësimi përmendësh i Kur’anit filloi të formësohet, të sistematizohet me metodat teknike si për shembull; në periudhën e selxhukëve formimi i “Darul Huffazit” dhe “Darul Kurras” tregon se mësimi përmendësh i Kur’anit ka marrë formë institucionale. Ky sistem ka vazhduar edhe në periudhën osmane.

1. Memorizimi i Kur’anit Famëlartë

Qysh prej fillimit të shpalljes i Dërguari i All-llahut përdori dy metoda për ruajtjen e tekstit të shenjtë të cilat ishin plotësuese të njëra-tjetrës, e para ishte të mësuarit përmendësh dhe e dyta ishte shkrimi i Kur’anit. Gjithashtu Arabët ishin të prirë në të mësuarit e poezive përmendësh, kështu që memorizimi i sureve të shkurtra që u shpallën në Mekke për ta ishin të lehta të mbaheshin përmendsh. Në lidhje me këtë mund të përmendet thënia e Sujutiut të cilën e ka cituar në veprën e tij “El Itkan”; “të gjithë fëmijët Musliman i mësuan suret e shkurtëra Mekkase, të cilat sipas shpalljes janë të parat dhe se në këtë ekziston një kuriozitet i madh i Zotit”.

Shumica e as’habëve rregullisht i mbanin në mend shpalljet e reja drejtpërdrejt nga Pejgamberi (a.s) dhe gjithashtu i shkruanin vet, respektivisht kishin përmbledhje personale të sureve të Kur’anit të cilat i kishin dëgjuar drejtpërdrejt nga goja profetike. Mësimi përmendësh i Kur’anit gjithnjë e më shumë vinte e rritej. Kështu mund të përmenden pjesët e Kur’anit të recituar përmendësh prej Xha’fer ibn Ebi Talib para Negusit në Abisini.²

Pasi u obligua që Namazi të falet publikisht, edhe më me intensitet është mësuar përmendësh Kur’ani, kurse prezenca e Pejgamberit (a.s) gjithnjë është shfrytëzuar që pjesët e harruara të ripërsëriten, me qëllim ikjes mundësive të gabimeve. Kjo metodë jo vetëm që siguronin përcjelljen dhe kalimin e shpalljes në mënyrë të pavarur, por gjithashtu shërbente si kontroll të brendshme që garantonte ruajtjen e përpiktë të tekstit.

Traditat Islame tregojnë që [i Dërguari i All-llahut](#) kishte caktuar disa mësues kryesorë, të cilëve u mësonte personalisht ajetet Kur’anore. Në këtë mënyrë u ruajt edhe drejtshqiptimi i Kur’anit. Këta mësues pastaj ndihmonin Muslimanët e tjerë që të mësonin përmendësh pjesët të shpallura të Kuranit. Përveç kësaj, ajetet e shpallura të Kur’anit, recitoheshin gjatë pesë

² Enes Kariç, *Hyrje në shkencat e tefsirit*, (Prishtinë, 2001), f. 87.

faljeve të përditshme. Kështu që mësimi përmendësh u bë mënyra kryesore e përcjelljes dhe transmetimit të shpalljeve të Kur'anit Famëlartë. Si rezultat mund të thuhet se teksti i Kur'anit u gdhend në zemrat e besimtarëve, kështu që mënyra e të mësuarit përmendësh doli si mënyra e vetme dhe më efektive për ruajtjen e shpalljes së Kur'anit. Bashkë me këto një herë në vit gjatë muajit të Ramazanit, Xhibrili (a.s) recitonte gjithë Kur'anin që ishte i shpallur deri atëherë Muhamedit (a.s). Duhet nënvizuar se pasi përfundoi shpallja e plotë e Kur'anit në Ramazanin e fundit të jetës së Muhammed'it (a.s), Xhibrili i recitoi atij të gjithë Kur'anin dy herë.

Ashtu siç po rritej numri i personave që po pranonin fenë Islame, po rritej gjithashtu procesi i të mësuarit Kur'anin përmendësh. Kur'ani u përhap nëpër hapësira të reja përmes procesit të të mësuarit përmendësh, si një metodë që siguroi ruajtjen e tekstit origjinal në formën e tij të pacenuar. Nga kjo nënkuptohet se Pejgamberi (a.s) e tuboi Kur'anin në zemrën e tij të pastër, e që ishte prijës i hafizëve të kohës së tij dhe bazë ku ktheheshin të gjithë Muslimanët kur u nevojitej ndonjë çështje në lidhje me Kur'anin dhe shkencat e Kur'anit dhe ua lexonte atë njerëzve. I ngjallte netët e vonta me Kur'an dhe e stoliste Namazin e tij me Kur'an. Për shoqëruesit e Pejgamberit (a.s) libri i Zotit ishte sendi më i çmuar. Vërehet se në disa raste Kur'ani ishte dhurat (mehër) i bashkëshortes duke ia mësuar asaj një sure nga Kur'ani.

Hafizat, e prishnin kënaqësinë e gjumit me një kënaqësi akoma më të madh, pra me leximin e Kur'anit, dikush kur kalonte pranë shtëpive të as'haveve gjatë natës, ndëgjonte zhurm si zukata e bletës nga leximi i Kur'anit.

I Dërguari i Zotit dërgonte nga shokët e tij persona që t'ua mësonin njerëzve Kur'anin, siç e dërgoi Mesab bin Umejrin dhe Ibni Umi Mektum tek banorët e Medinës para hixhretit që atyre t'ua mësojnë Islamin dhe t'ua lexojnë Kur'anin, siç e dërgoj Muadh bin Xhebelin (r.a) në Mekke pas hixhretit për t'ua mësuar leximin dhe mësimin përmendësh të Kur'anit. Nga kjo mund të vijmë në konkluzionin se hafizat në kohën e Pejgamberit (a.s) ishin të shumtë, ndër ta veçojmë: Katër hulefai Rashdinët, Talha, Sead, Ibni Mes'udi, Hudhejfe, Salim, Meula Ebi Hudhejfe, Ebu Hurejre, Ibn Omeri, Ibn Abasi, Amr bin As dhe biri i tij Abdullahi, Muavija Ibn Zubejr, Aishja, Hafsa, Umi Selma etj.

2. Mrekullia e Memorizimit (të Mësuarit përmendësh) të i Kur'anit Famëlartë

Kur'ani është libër i cili nga pamja e jashtme të duket sikur të gjitha librat tjerë të rëndomtë, por nga përmbajtja dhe kuptimi nuk i ngjason dhe nuk mund t'i ngjasojë asnjë libri

tjetër në botë. Ai në momentet e para të shpalljes së tij, fillimisht është mësuar përmendësh nga besimtarët, ndërsa paralelisht është shkruar, renditur si dhe është materializuar në mjetet e kohës, përmes skalitjes në rrasa gurësh, në lëkura dhe eshtra kafshësh, lëvore drunjtesh etj. Kjo gjendje e cila e ka përcjellë atë deri në zbulimin e mjeteve të shkrimit bashkëkohor.³

Për dallim nga librat e tjerë të rëndomtë Kur'ani, përveç që është shkruar vazhdimisht, është përcjellë edhe nga një element tjetër shumë i rëndësishëm, me atë të memorizimit. Të mësuarit përmendësh dhe shkrimi kanë qenë dy shtylla bazë të cilat e kanë ruajtur deri më sot origjinalitetin e tij nga devijimi i mundshëm, qoftë edhe nga më i vogli. Është i vetmi libër mbi sipërfaqen e tokës që memorizohet, ku ne gjejmë mijëra të ri e të reja, madje dhe fëmijë që kanë memorizuar Kur'anin. Muslimanët memorizimin e Kur'anit e konsiderojnë akt devotshmërie.

Kur'ani si dekret i fundit hyjnor, është i vazhdueshëm dhe do të mbetet i tillë deri në Ditën e gjykimit. Kjo është arsyeja pse All-llahu Fuqiptotë ka garantuar ruajtjen e plotë të Kur'anit nga çdo shtrembërim dhe çdo ndryshim, qoftë edhe një shkronje të vetme të tij. Në suren el-Hixhr, ajeti 9, i Plotëfuqishëm thotë: “إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ” - *Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij!*⁴ - Pra, All-llahu Fuqiptotë mbronë Kur'anin nëpërmjet njerëzve të zgjedhur - hafizëve të Kur'anit. Gjithashtu sipas Imam Xherir et Taberit me fjalën (*hafidhun*) nënkuptohet se: “All-llahu e mbron Kur'anin që të mos shtohet ndonjë fjalë e kotë e cila nuk i përket, apo të lë mangët ndonjë dispozitë të tij.”⁵ Pra, Kur'ani nuk do të përjetojë të njëjtin fat që e përjetuan librat e mëparshëm të shpallur të cilët u falsifikuan dhe u ndryshuan dispozitat e tyre nga vet ithtarët e tyre.

Mund të lind pyetja: Pasi që All-llahu Fuqiptotë e morri në mbrotje Kur'anin dhe e garantoi, atëherë, pse as'habët u angazhuan në mbrojtjen dhe tubimin e Kur'anit, madje, edhe sot e kësaj dite mësohet përmendësh? – Përgjigjësja e kësaj pyetje është në vet ajetin e sipërpërmendur, ngase, si ata që e tubuan Kur'anin si ata që vazhdimisht e mësojnë përmendësh Kur'anin janë shkak për mbrotjen e Kur'anit Famëlartë.⁶

³ Salih Subhi, *Mebahith el Kur'an el Kerim* (Dar el Fikër, Damask 1968), f. 69.

⁴Hixhr, 15/ 9.

⁵Xherir et Taberi, *El Xhamië el Bejan fi tefsir el Kur'an* (Dar et turath el Islamij, Kajro, 1988), vëll. XIV, f. 7

⁶ Elmallëil Muhamed Hamdi Jazër, *Hak dini Kur'an dili* (Metbai Ebuzziyai, Istambull, 1935), vëll. V, f. 214

Bazuar në më sipër, ne arrijmë të kuptojmë mëshirën e All-llahut Fuqiplotë ndaj njeriut, ku kësaj krijese kaq të vogël, e ka nderuar me faktin që në zemrën e tij të mban dritën e zërit të Tij. Sikur All-llahu Fuqiplotë të mos forconte zemrat e besimtarëve, ata nuk do të ishin në gjendje për të mësuar ose kuptuar kuptimin e tij. All-llahu Fuqiplotë tha: “*Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi ndonjë kodër, do të shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua sjellim njerëzve, që ata të mendojnë.*”⁷ - A mund të krahasohet fuqia e zemrës njerëzore me kodrat e larta? Por i Plotëfuqishmi nga mirësia e Tij forcoi zemrat e besimtarëve dhe i ndihmoi ata për të bartur dritën e Kur’anit.⁸

Shumë studime bashkëkohore potencojnë efektet pozitive të mësuarit përmendësh të Kur’anit, sipas tyre, memorizimi forcon imunitetin e trupit dhe ia shton besimtarit kreativitetin si dhe qetësinë shpirtërore. Mund të përmendim studiuesin Dr. Ibrahim bin Saleh Sani’n, profesor i psikologjisë në universitetin el-Imam Muhamed bin Saud të Riadit, ka bërë një hulumtim që shqyrton se ata që kanë mësuar përmendësh një numër të madh ajetesh të Kur’anit gëzojnë një nivel më të lartë të shëndetit mendor, pavarësisht nga mosha, gjinia apo niveli arsimor. Rreth 70 studime hulumtuese janë kryer në lidhje me besimin dhe shëndetin mendor, përfshirë 28 në vendet islamike.⁹ Ndërkaq, Dr. Abdullah Subejh, profesor i psikologjisë në Universitetin Islamik në Rijad, bëri apel te studentët që t’iu bashkëngjiten kurseve (hallkave), duke sqaruar se mësimi i Kur’anit përmendësh ndihmon për përqendrim, e që është një element i shumëkërkuar gjatë arritjes së dijes.

All-llahu Fuqiplotë në Kur’an thotë: “Ne Kur’anin e bëmë të lehtë për të studiuar, a ka ndokush që merr përvojë nga ai?”¹⁰ Nga kjo arrihet të nënkuptohet se Kur’ani Famëlartë është libër pa shëmbëllim dhe i pashoq, i cili është ruajtur me një kujdes dhe ndjeshmëri të jashtëzakonshme, ku të memorizuarit është forma kryesore me të cilën është mbartur Kur’ani me radhë shekuj, brez pas brezi deri më sot.

Memorizimi i Kur’anit nga mijëra besimtarë, edhe sot kudo në botë garanton që edhe në rastin ekstrem, të zhdukeshin të gjitha librat që sot ekzistojnë, i vetmi do të ishte Kur’ani, i cili do të mund të rikthehej në autenticitetin e tij të mëparshëm.

⁷Sure Hasher, 21.

⁸Ebu-Abdullah Muhammed bin Ahmed el-Ensari el Kurtubi, *El Xhamië li ahkam el Kur’an el mubin*, (bot.Dar el Fikër, Bejrut, 2006), vëll. I, f. 38

⁹ Revista:Rijad, nr. 26271

¹⁰ Sure el Kamer, 40.

3. Tradita e Hifzit te Shqiptarët e Maqedonisë

Tradita e hifzit është e njohur dhe është ndjekur me përpikëri nga besimtarët Musliman shqiptarë që me kontaktet e para me fenë islame, ku janë krijuar edhe institucione të veçanta, komisione, dhe janë caktuar rregulla ceremoniale për këtë qëllim. Kështu që mund të thuhet se Shqiptarët, sikur Muslimanët e tjerë të botës, brez pas brezi kanë kultivuar traditën e të mësuarit të Kur'anit përmendësh, nga gjiri i së cilit do të dalin hafiza të shquar.

Rreth fillimit të hifzit tek shqiptarët nuk mund të përmendim ndonjë vit konkret, por mund të konstatojmë se prej shekullit të XVI, në hapësirën Shqiptare zë fill kultivimi i hifzit. Të rrallë kanë qenë rastet që nxënësi që ka përfunduar medresen në trevat shqiptare apo ka mësuar tek ndonjë hoxhë në formën didaktike, e të mos ketë kryer paralelisht edhe hifzin.¹¹ Për sa i përket hifzit në Republikën e Maqedonisë, është mësuar çdoherë madje edhe në kohërat më ekstreme, siç ishte ajo e sistemit komunist. Në kohën e diktaturës komuniste, disa prej hafizave të këtij rajoni rrezikuan jetën dhe familjet e tyre, vetëm e vetëm që të vihet në shërbim të Islamit, duke mësuar hifzin aty-këtu fshehurazi, duke u ballafaquar me lloj-lloj sfidash, maltretime fizike e psiqike, por gjithnjë ia dolën mbarë në këtë mision të shenjtë e sublim dhe nuk ngurruan që as shtëpitë e tyre t'i shndërrojnë në mektebe. Disa nga to madje vuajtën dënime të rënda dhe u dërgjën me vite të tëra nëpër burgjet dhe kazamatet e egra famëkeqe, por edhe përkundër kësaj, ata të pajisur me ndjenjat e larta fetare, morale dhe kombëtare, të palëkundur dhe me dinjitet, mbrojtën fenë dhe Kur'anin Fisnik.¹²

4.1. Shkupi me rrethin

Shekulli XVI është koha kur zë fillë kultivimi i hifzit në trojet tona shqiptare në Republikën e Maqedonisë. Për këtë dëshmon fakti se Evlija Çelebiu në udhëpërshkrimin e tij ka evidentuar Darr el Kur'ra në Shkup, Shtip dhe Ohër. Me plotë të drejtë mund të thuhet se Shkupi është vatër e hafizëve të Kur'anit Fisnik, sepse qysh nga ekzistimi i Islamit në këto troje, ka ekzistuar institucioni i hifzit. Ndërkaq, kultivimi i hifzit në formë Instiucionale në Shkup fillon nga janari i vitit 1992 me iniciativ e ish Myftiut, hafiz Rexhep Nuredini në kuadër të Këshillit të Xhamisë Isa Beu në Shkup. Me propozim të Këshillit të Bashkësis Islamë - Mytina e Shkupit, nr. rendor 267 të datës 30 shtator 1993, me aktin 1390/24 nëntor

¹¹ Zeka, 1997: f. 207.

¹² Ismail Bardhi, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Egzgjekja e tij Kur'anore* (bot. Logos-A, Shkup, 1998), f. 66.

1993, Kryetari i Meshihatit, Hxh. Sulejman efendi Rexhepi nxjerr vendimin me të cilin emron hafiz Taip Aliun përgjegjës për kultivimin e hifzit në Myftinin e Shkupit.¹³

Është mirë që këtu të përmendim disa emra të hafizave shqipëtarë gjatë shek. XX të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm si në aspektin teologjik, ashtu edhe në atë kulturor të kombit Shqiptarë. Edhe pse është vështirë që të afrohet numri egzak i hafizave, në vijim do të potencojmë disa hafizët më të njohur.

Muhaffiz Idriz Idrizi, lindi në Shkup më 15 nëntor të vitit 1936. Hifzin dhe mësimet e para i kreu te hafiz Ibrahim, në vitin 1947. Në vitin 1952 bashke me vëllain e vet hafiz Ademin e hapi Xhaminë në lagjen Dyanxhik ku shërbeu si imam. Në vitin 1981 ka marr pjesë në garat e hifzit të Kur'ani Kerimit në Libi. Nga hafiz Idrizi zën dije si nga mësimet Islame ashtu edhe në këndimin e Kur'anit, ndër to: hafiz Sabiti, hafiz Abdalbakiu, hafiz Atullahi, hafiz Bunjamini, hafiz Adnani etj. Ai, ndërroi jetë më 17 nëntor të vitit 2005.

Muhaffize Fetije Alija (Hafizka e madhe), është e lindur në vitin 1939 në fshatin Nikushtak të Kumanovës. Jetoj dhe veproj në Hasan beg – Shkup. Hifzin e filloi te Ferhat efendiu, por e kreu te Molla Qazim efendi në vitin 1949. Provimin e hifzit e dha para komisionit në përbërje: hafiz Abdurrahimit dhe hafiz Hasanit në Shkup.¹⁴ Pas mbarimit të hifzit ajo iu përvesh aktivitetit islam (mësimbesimit) në të cilin gjente kënaqesinë e saj, duke privuar veten nga martesë për t'iu përkushtu kësaj detyre që e kishte marr mbi supet e saj, e cila hyn nën kthetrat e Hadithit të Pejgamberit (a.s): “Më i mirë prej jush është ai që mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve”¹⁵, nga e cila kanë dalë shumë hafiz të cilët sot mbartin funksione të larta, shkencëtarë, dhe dëshmor të kombit. Ndër hafizët e saj shquhen: hafiz Ismail Bardhi, hafiz Harun Aliu. Hafiz Mevlud Aliu, Kryeimam pran Myftinis së Shkupit. Hafiz Lukman Aliu, hafiz Shirete Aliu, hafiz Rafiz Aliu etj. Vlen të theksohet se e tërë familja e saj, nipat dhe mbesat e hoxhe Ramadanit, përfshirë këtu edhe mulla Qazimin si mualim (muhafiz) gjithësejt janë 20 hafiza.

Muhaffizi Taip Aliu, ka lindur më 20 qershor 1953 në fshatin Gërçec të Shkupit. Shkollën fillore e ka kryer në Shkup më 1969, kurse të mesmen në Hums - Siri. Hifzin e përfundoi në vitin 1970 te hafiz Idriz Shabani. Hifzin e dëshmoi para komisionit në përbërje:

¹³Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë, Leksikonë (Shek XVIII- 2010)* (Shtypi Tringa Desing, Prishtinë, 2010), f. 14

¹⁴Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë, f. 40.*

¹⁵Ebu Zekerija Jahja bin Sheref el Hazmi en Nevevi, *Rijadus-salihin* (Logos A, Shkup, 1995), nr. 1000.

hafiz Shaban Saliu, hafiz Ali Qahili, hafiz Hasan Lila. Ndër hafizet që mësoi tek muhaffizi i respektuar është hafiz Lejla Alili.

Vlen të theksohet që muhaffizi i nderuar që me përfundim të hifzit, viti 1970, ka kënduar mukabele me mus'haf të mbyllur në të gjitha Xhamitë e Shkupit. Gjithashtu, ka qenë edhe antar i hifzit në të gjitha komunitat e Maqedonisë.¹⁶

Muhaffizi Isa Bektashi, lindi më 28 shkurt 1965 në Tanush - Shkup. Hifzin e kreu te Idris ef Ibrahimimi, imam i Allaxhe Xhamisë në Shkup. Është nga hafizët që e fali namazin e taravive me hatme të Kur'anit. Te hafiz Isa hifzin kanë kryer: hafiz Reshati, hafiz Llukman Arifi, hafiz Muhsin Sulejmani dhe hafiz Imer Iseini. Gjithashtu ka qenë anëtar i komisionit për hifz në Myftinin e Shkupit.

Lirisht mund të themi se Shkupi është qendër e hifzit i cili aktualisht numron mbi 400 hafiza të Kur'anit Famëlartë. Ndërkaq, vetëm fshati Studeniçan i cili ndryshe quhet "Fshati i Hafizëve" numron mbi 100 hafizë.

Hafizi Xhemail Nuhiu, përndryshe nga fshati Moranë e Shkupit, student pran FSHI-së, ka arritur të marrë vendin e katërt në botë në garën prestigjioze të leximit të Kuranit që u mbajt në Teheran të Iranit.

Të jetosh në Shkup, në qytetin i cili para disa dekadash ishte qyteti me më shumë Shqiptar, nuk mund të imagjinohet që vatra e mësimave Islame, Medreseja "Isa Bek" të qëndrojë indiferente nga institucioni i emorizimit të Kur'anit. Andaj këtij institucioni do ti qasen me plotë përkushtim hafiz Shevali dhe hafiz Shafi Osmani njëherit pedagog të lëndës së kiraetit, ku Medreseja, që nga hapja deri më sot ka nxjerr 35 hafiz

4.2. Kumanova me rrethin

Kumanova që shquhet me heroizëm dhe qëndresën e saj, popullit tonë jo vetëm që i dha heronj, trima dhe intelektual, por shquhet edhe me hoxhallar dhe hafizllar. Duke filluar që nga viti 1940 e deri më sot Kumanova shquhet me një numër të konsiderueshëm të hafizëve të Kur'anit, ku sot Kumanova numron 110 hafiza.

¹⁶Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historis, Leksikonë (Shek XVIII- 2010)*, f. 48.

Sipas rrëfimeve të hoxhë Ibrahim Latifit, Imam në Xhaminë e fshatin Opajë, përshkruan kohë moniste me lot në sy, dhe thontë: “Nga friga për të mësuar Kur’anin unë dilsha në fushë dhe hypsha në një pemë kurse hafizi lexonte Kur’anin posht me qëllim që mos të na hetojnë, nëse na hetonin menjëherë na burgosnin.”

Muhaffizi Refik Ajeti, nga Komuna e Likovës, i cili ka dhënë një kontribut të madh në këtë drejtim. Numri i hafizëve që kanë dalë nga ky muhaffiz arrinë në 27, ndër të cilët do të veçoja kariun (recituesin) me përmasa botërore hafiz Aziz Aliun. Edhe pse muhaffizi e humbi të pamurit punoi shumë në këtë drejtim, të cilën traditë e vazhdon djali i tij hafiz Bajram Ajeti.¹⁷

4.3. Tetova me rrethin

Për sa i përket kultivimit të hifzit në Komunën e Tetovës ai është shumë i hershem. Si hafiz të shekullit të kaluar tetovarët kujtojnë.

Muhaffiz Abdulxhemil ef. Jusufi (Xhemil efendija), lindi në vitin 1853 në Tetovë. Hifzin fillimisht e kreu te hxxh. Jusuf Lakushi, por kur shkoi për të vazhduar shkollimin në Stamboll, aty ka viti 1870, edhe një herë e verifikoi hifzin në një afat brenda gjashtë muajsh te hafiz Kamil Istambulli – imam në Xhaminë Valide Sulltan në Aksaraj, i cili mbahet mend me falje të namazit të taravive me hatme dhe lexim të Kur’anit përmendësh para auditoriumit nga i cili dolën shumë hafizë. Mësimet i vazhdoi në medresen Fatih ku përvetësoi lëndët bazë të Islamologjisë: akaid, fik’h tefsir, hadith, ilmu-l-kelam etj. nga ixhazetja e tij vërehet se ka marr njohuri nga dijetar të shquar të asaj kohe si: hafiz Ibrahim ef. Timurhisari, Shejh Ismail ef. Konjevi, Haxhi Osman ef. Razgadi etj. Kthehet në vendlindje ku themelon Medresen e tij aty pran Xhamisë së Pashës në Tetovë. Ndëroi jetë në vitin 1961.¹⁸

Në ditët e sotme, vetëm nga muhafizi i mirënjohur Mulla Mahmud Asllani, i cili me veprimtarinë e hifzit merret që nga viti 1967.¹⁹ Që nga fillimi e deri në ditët e sotme, aty në Xhaminë e Pashës në Tetovë, muhafizi i nderuar ka nxjerr 167 hafiz, në proces e sipër janë edhe 6 kandisat të tjerë, kurse i fundit që bëri ceremonin e hifzit më 15 dhjetorë 2015. Në familjen e muhaffizit ka gjithësejt 11 hafiz, ku hapat e tij i ndjek djali i tij hafiz Abdurrahman

¹⁷ Enver Zeqiri, *Historiku i Komunsë së Kumanovës* (Kumanovë, 2012), fq. 243

¹⁸ Ismail Nuhiu, *Punim diplome: Hafizët më të njohur në Tetovë dhe rrethinë gjatë shek. XX* (Prishtinë, 2008), f.16.

¹⁹ Muaz Asllani, *Mulla Mahmud Asllani*, Revista Hëna e Re, Shkup,(Dhjetorë, nr.43, 1992), fq. 20

Asllani, i cili me këtë veprimtari ka filluar që nga viti 1989 në xhaminë “Kadi çeshme“ i cili gjithësejt ka nxjerr 10 hafiz.²⁰

4.4. Gostivari me rrethin

Sa i përket kultivimit të hifzit në rajonin e Gostivarit, ai dallohet me një numër të konsiderueshëm të hafizëve. Në të kaluarën nuk gjendej fshatë e të mos ketë hafiz. Gjatë peridhës moniste në mënyrë të organizur më tepër hafizllar ka nxjerr.

Muhaffizi Kamber Kamberi, Imam në Xhamin e Mehallës në Gostivar ka nxjerr një numër të konsiderueshëm të hafizëve, i cili për shkak subjektive do të emigroj në Turqi. Ndër hafizët që ka nxjerr janë: hafiz Jakup Jakupi imam në xhamin e Saatit, hafiz Galip Sulejmani imam në Xhamin e Kadrit. Këtë traditë do ta vazhdoj muhaffizi Besir Imeri i cili do të nxjerrë pesë hafiz. Këtë traditë do ta vazhdoj muhaffizi Besir Imeri i cili do të nxjerrë pesë hafiz, si dhe muhaffizi hafiz Arif ef Emiri, ligjërues në Xhamin e Lajthis dhe aktualisht profesor i lëndës së kiraetit në Medresen e vajzave në Myftinin e Gostivarit i cili deri tash ka nxjerr 4 hafize.

Aktualisht Gostivari numron mbi 50 hafiz, prej tyre janë katër femra, ndërkaq hafiz më të ri janë dy vëllezrit nga fsh. Bajnic të cilët në vitin 2015 bënë ceremonin e hifzit. Në Gostivar siç edhe në komunat tjera, dikur nga disa hafizë, gjatë muajit të Ramazanit namazi i taravisë është falur me hatme dhe është praktikuar këndimi i Kur’anit, mukabelja. Kjo traditë e këndimit të Kur’anit është përcjellë deri në ditët e sotshme. Akoma edhe sot, në Xhaminë e Sahatit, në qytetin e Gostivarit lexohet *mukabele*. Gjatë tre muajve të shenjtë me Kur’an mbyllur lexonte mukabele hafiz Faredin Ibrahim, i lindur më 1936 në fshatin Vrapçisht. Hifzin e kreu në vitin 1947, në moshën 11 vjeçare. Që nga viti 1984 dhe deri në vitin 2015 në Xhaminë e Saatit në Gostivar në namazin e drekës këndon mukabele, kurse në ikindi në Xhamin e Mahallës.

Këtë nismë e ka filluar hafizi i mirënjohur i pollogut Abdulxhemil ef. Jusufi, e cila traditë nuk është ndërprerë deri më sot, ku nga ky dijetar i madh dolën kuadra të mëdhej jo vetëm nga Tetova dhe Gostivari por edhe më gjerë. Andaj, Kërçova kujton hafiz Qeshaf ef. Ahmedi nga Zajazi i cili ishte njëri nga nxënësit e Xhemil efendisë²¹.

²⁰Gojdhenë, Muaz Asllani, Dhjetor, 2015.

²¹ Abdulxhemil Nesimi, *Memorizimi i Kuranit tek shqiptarët e Maqedonisë në dekadat e fundit*, Sesion shkencorë : Kurani te Shqiptarët (Shtypi Iliri, Prishtinë, 2016), fq. 108.

4.5. Struga dhe Ohri

Komuna e Strugës aktualish nuk posedon asnjë hafiz të Kur'anit Famëlartë. Mirëpo, Struga kujton hafizin e fundit Sabit Shehun. U lind në vitin 1924 në fshatin Velesht, kurse hifzin e mbaroi në korrik të vitit 1936 para komisionit në përbërje prej: hafiz Abdullah Salih (kryetar) një herit Kadi i Ohrit, hafiz Emrullah Xheladini, hafiz Ibbrahim ef Gulent dhe hafiz Fehimi, që të gjithë nga Ohri.

Hafiz Sabiti mësimet e para i morri tek hafiz Osman Maliqi, i cili ishte mualim familjar i Sulltanit, të cilin Sulltani do ta autorizoj si Imam në Strug. Është e veçant se imami i nderuar edhe pse nuk e dinte gjuhën shqipe, ai nuk pranonte kombësi tjetër pos asaj shqiptare.

Hafiz Sabiti më 27. 07. 1943 nga Kryetari i Komunitetit Shqiptar, hafiz Sherif ef. Langu me seli në Tiranë, do të emrohet imam i Kareshit. Hafizi i nderuar ndroi jetë më 30 gusht 2011 (Bajram), kurse Struga do të humb hafizin e fundit të saj.

Qyteti Ohrit në të kaluarën shquhej me katër Medreset e saj nga të cilat dolën një numër i konsiderueshëm i hafizave, të cilat medrese kanë funksionuar deri në vitet 1920-1924. Me kalimin e kohës medreset janë zhdukur kurse memorizimi i Kur'anit ka vazhduar nëpër mektebe, xhamija, shtëpi deri në vitin 1970.

Prej hafizllarve të fundit kanë qenë: hafiz Osman, hafiz Emrullahu, hafiz Musa, hafiz Shabani, hafiz Muharem dhe i fundit ka qenë hafiz Kadri ef. Pollozhani i cili ka vdekur në vitin 2011. Aktualisht në qytetin e Ohrit nuk ka asnjë hafiz

4.6. Dibra

Duke i pasur parasysh faktorët gjeopolitike, dhe faktin se hifzi kërkon një përkushtim më afatgjatë dhe të vazhdueshëm, bëri që numri i hafizëve në territorin e Dibrës dhe rrethinës të bjerë në formë drastike.

Aktivitetet pas Luftës së Dytë Botërore janë vetëm angazhime personale të hoxhallarëve dhe shpeshherë të ndërprera. Aktiviteti ka qenë i shtrirë si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra. Prej asaj kohe (1945) e këtej, Dibra ka pasur vazhdimisht vetëm dy apo tre hafizë, bile ashtu vazhdon edhe sot, ku kemi vetëm dy hafizë, ndërsa shkolla të veçanta për hifz gjatë gjysmës së dytë të shek. XX nuk ka pasur.

Për sa u përket komunave tjera si: Manastiri, Kërçova, Velesi, Shtipi, ky institucion i takon të kaluarës. Në këto rrajone sot nuk gjendet asnjë hafiz i Kur'anit Famëlartë. Siç u theksua më lartë, numri i hafizëve vështirë se mund të përcaktohet me saktësi, por e shoh me rëndësi të themi se ndër trojet shqiptare Maqedonia ka qenë dhe akoma është vend i njohur i hafizëve, imamëve dhe vaizëve.

Konkluzion

Nëse këtë kumtesë e analizojmë pak më thellë, fare lehtë do të kuptojmë se në pjesën perëndimore të Maqedonisë me shumicë shqiptare, kultivimi i hifzit ka patur një jehon shumë të madhe të zhvillimit edhe përkundër presioneve të egra nga sistemi i atëhershëm sllavo-komunist, disa hafiz të këtij rajoni rrezikuan jetën dhe familjet e tyre, vetëm e vetëm që të vihet në shërbim të Islamit, duke kultivuar hifzin aty-këtu fshehurazi dhe duke u ballafaquar me lloj-lloj sfida, maltretime fizike e psiqike, por gjithnjë ia dolën mbanë në këtë mision të shenjtë e sublim edhe përkundër mënyrave nga më të ndryshmet që përjetuan në kurriz të tyre. Ndërkaq sot pas disa dekadash kemi një zbehje të kultivimit të hifzit në disa komuna.

Për vetë faktin se termi “hafiz” në vendet tona i dedikohet pikërisht personit që e ka mësuar Kur'anin përmendësh, megjithatë hafizët radhiten ndër patriotët në kuptimin e gjerë të fjalës, sepse vetëm njerëzit me dije mund t'i dalin zot, në rrethana të caktuara atdheut dhe popullit të vet për ta udhëhequr në rrugë të mbarë të zhvillimit dhe të përparimit. Kështu që mësimi i Kur'anit përmendësh tek shqiptarët, jo vetëm që është ruajtur por solli edhe deri te krijimi i një tradite të gjerë, si të leximit ashtu edhe të memorizimit, përkthimit dhe interpretimit.

Bibliografia

- Bardhi, Ismail, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Egzegjeza e tij Kur'anore*, (Logos –A, Shkup, 1998).
- Kurani i Madhërishtëm*, perktheu Hasan I. Nahi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë 2006.
- Yazır, Elmalılı Muhammed Hamdi, *Hak Dini Kur'an Dili, Elmalil Tefsir*, (Metbaai Ebu ziya, İstanbul, 1935).
- Kariç, Enes, *Hyrja në shkencën e tefsirit* (Prishtinë, 2001).

- Kurtubi, Ebu-Abdullah Muhammed b. Ahmed el-Ensari, *El Xhamië li ahkam el Kur'an el mubin* (Dar el Fikër, Bejrut, 2006).
- Mehdiu, Feti, *Hafizt tanë gjatë histories Leksikon (Shek. XVIII- 2010)*, (Shtypi Tringa Disajn, Prishtinë, 2010).
- Nesimi, Abdulxhemil, *Memorizimi i Kuranit tek shqiptarët e Maqedonisë në dekadat e fundit, Sesion shkencorë : Kurani te Shqiptarët* (Shtypi Iliri, Prishtinë, 2016).
- Neveviu, Ebu Zekerija Jahja bin Sheref el Hazmi, *Rijadus-salihin*, (bot.Furkan, Shkup, 1995).
- Nuhi, Ismail, punim diplome: *Hafizët më të njohur në Tetovë dhe rrethinë gjatë shek. XX*, (Prishtinë, 2008).
- Salih, Subhi, *Mebahith fi ulumil Kur'an*, (Dar el fikër, Bejrut, 1968).
- Sujuti, Xhelaluddin Abdurrahman, *El Itkan fi ulumil Kur'an* (Dar el Fikër, Bejrut, 1996).
- Taberi, Ebu Xha'fer Muhamed ibn Xherir, *Xhamiul bejan an te 'vili aja el Kur'an*, (Dar el Fikër, Bejrut, 1988).
- Teufik, Muftić, *Fjalor arabisht-boshnjakisht*, (Jugoslavia, Sarajevë, bot. II, 1984).
- Zeka, Ramiz, *Zhvillimi i kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, (Tiranë, 1997).
- Zeqiri, Enver, *Historiku i muftinis së Kumanovës*, (Kumanovë, 2012).

Revista:

- Muaz Asllani, *Mulla Mahmud Asllani*, Hëna e Re, Gazet Kulturore informative Islame (Dhjetorë, nr. 43, 1992).
- Gojdhënë, Muaz Asllani, Dhjetor, 2015.
- Rijad, Revist, shkrim i publikuar në rjetin social:
<http://www.arabnet5.com/news.asp?c=2&id=26271>.